



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUĐSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.149/2022

Datë: 20 prill 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Riza Livoreka, gjyqtar në Gjykatën Themelore Ferizaj –Dega në Kaçanik, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/02/2022/GJTHFZ-AD.nr.01/2022, të datës 1 prill 2022, pas shqyrtimit të bërë në pajtim Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe bazuar në nenet 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën e mbajtur më datë 20 prill 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** marrëveshja vullnetare për pranimin e fajësisë për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/02/2022/GJTHFZ-AD.nr.01/2022, e lidhur në mes të panelit hetimor dhe gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj –Dega në Kaçanik z.Riza Livoreka.
2. Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik z.Riza Livoreka është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.8, 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe paragrafi 5, pika 5, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, dhe të njëjtit i shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës në lartësi prej 40% në kohëzgjatje për dhjetë (10) muaj, të përcaktuar me dispozitën e nenit 7, paragrafi 1, pika 1.3 të të njëjtit Ligj.
3. Revokohet vendimi i KGJK-se me numër KGJK.Nr.40/2022, për suspendimin e gjyqtarit Riza Livoreka, i datës 27 janar 2022.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.39/2022, të datës 27 janar 2022, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/02/2022/ GJTHFZ-AD.nr.01/2022, më datë 1 prill 2022, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin për këtë lëndë disiplinore, si dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë në mes të panelit hetimor dhe gjyqtarit Riza Livoreka.

Për të shqyrtuar raportin hetimor dhe marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë, të arritur mbi pranimin e fajësisë të lidhur në mes të gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj –Dega në Kaçanik z.Riza Livoreka dhe panelit hetimor, KGJK më datë 20 prill 2022, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore. Nga raporti hetimor u vërtetua se gjyqtari Riza Livoreka ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, që përcakton “ shkelje të detyrave të Gjyqtarit”, që përfshinë veprimet e mëposhtme në çoftë

se gjyqtari i kryen me dashje apo nga pakujdesia e rëndë”, nën paragrafi 2.8, përcakton kur “përfshihet në çfarëdo komunikimi ex-parte lidhur me lëndët”, nën paragrafi 2.15, përcakton shkeljen disiplinore “përfshihet në sjellje qoftë kur është në detyrë apo privatisht të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës, ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit”, sipas Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, dhe paragrafit 5, pika 5.5, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar ku është përcaktuar se “gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë efikase dhe të ligjshëm”.

Për panelin hetimor ka qenë jo kontestuese se subjekti i hetimit me këtë rast gjyqtari Livoreka ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara me lartë dhe si rrethanë renduese me këtë rast janë bisedat me njërin palë lidhur me lëndën në procedurë gjyqësore, biseda këto të publikuara në TV Dukagjini, me datë 26.01.2022.

Gjatë procedurës tek paneli hetimor subjekti i hetimit dhe paneli hetimor kanë arritur marrëveshje vullnetare me të cilën subjekti i hetimit z.Livoreka ka pranuar përgjegjësinë disiplinore me të cilën është ngarkuar sipas pikës 2.8 dhe 2.15 të paraparë në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve dhe ka pranuar që ti shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i pagës për 40% për dhjetë (10) muaj, siç është përcaktuar në nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të të njëjtit Ligj.

KGJK, vlerësoi se marrëveshja vullnetare për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të gjyqtarit Riza Livoreka dhe panelit hetimor, së bashku me dakordimin e tyre për llojin e sanksionit disiplinor të përcaktuar në nenin 7 paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, i përmbush të gjitha kushtet ligjore dhe se edhe sanksioni i propozuar nga ana e tyre është i drejtë dhe në proporcion me shkeljen disiplinore të tij, andaj si të tillë edhe e aprovoj.

Pasi që KGJK, ka miratuar marrëveshjen vullnetare për pranimin e fajësisë të arritur në mes të panelit hetimor dhe subjektit të hetimit, është vendosur edhe për revokimin e vendimit të KGJK-së me numër KGJK.Nr.40/2022, të datës 27 janar 2022 për suspendimin e gjyqtarit Riza Livoreka.

Vendimi u mor njëzëri nga ana e anëtarëve të pranishëm të Këshillit Gjyqësor.

Me sa u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.149/2022, datë 20 prill 2022

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Mustafë Tahiri,, Kryetar, Gjykata Themelore në Ferizaj;
- Riza Livoreka, Gjyqtare, Gjykata Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik;
- Arkivit.